



VENDIMET E BORDIT TË FBK-së të DATËS 21.11.2023, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në mbledhjen e mbajtur më 21.11.2023 në Prishtinë ka shqyrtuar situatën aktuale në basketbollin kosovar dhe, ndër të tjera, ka vendosur si në vijim:

1. Konform nenit 9 të Rregullores për Shpalljen e Laureatëve të Vitit në Basketboll, ka vendosur që ceremonia e shpalljes së Laureatëve të Vitit 2023 të FBK-së të mbahet më 21 dhjetor në Prishtinë.
2. Miratoi identitetin e ri të Superligës së Femrave dhe ligave të tjera të femrave/vajzave dhe ka vendosur që për herë të parë para opinionit ta lansojë logon dhe elementet tjera përcjellëse në ceremoninë e shpalljes së Laureatëve të Vitit 2023 të FBK-së.
3. Konform Nenit 30 të Rregullores për Përfaqësueset e Kosovës, emëroi trajnerët dhe ndihmës-trajnerët e Përfaqësueseve të Reja të Kosovës, përkatësisht U16M, U16F, U18M, U20M, me përbërjen si në vijim:
 - **Kosova U16 Meshkujt:**
Përzgjedhës Dion Pllana dhe ndihmës-trajner Dëfrim Hashani.
 - **Kosova U16 Femrat:**
Përzgjedhës Hasan Bytyqi dhe ndihmës-trajnere Melda Baliqi.
 - **Kosova U18 Meshkujt:**
Përzgjedhës Brahim Veseli dhe ndihmës-trajnerët Elbesar Gështenja dhe Hekuran Husaj.
 - **Kosova U20 Meshkujt:**
Përzgjedhës Dritëro Sefaja dhe ndihmës-trajner Safet Kastrat.
 - **Për shtabin teknik të Kosova U18 Femrat dhe Kosova A Femrat do të vendoset deri në mes të muajit dhjetor, si dhe për ndihmëstrajnerët e tjerë të Përfaqësueseve të lartpërmendura.**
4. Miratoi kërkesën e Shoqatës së Gjyqtarëve të Federatës së Basketbollit të Kosovës (SHGJFBK) për rritje të taksës të personave zyrtarë të ndeshjeve për ligat e kategorive të reja duke filluar nga janari i vitit 2024.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





5. Të bëhet ri-organizimi i zyrës ekzekutive të FBK-së përmes ndryshimeve në Rregulloren për Organizim të Brendshëm të FBK-së dhe rrjedhimisht të hapet konkurs për vende të reja të punës konform Rregullores për Organizim të Brendshëm të FBK-së të miratuar fillimisht nga Bordi.

Në emër të Bordit Ekzekutiv të FBK-së,

Arben **FETAHU**
Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës



Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:

